



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2022:262208
Datë: 07.05.2024
Numri i dokumentit: 05659471

Pml.nr.245/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mejreme Memaj, kryetare Agim Maliqi dhe Rasim Rasimi, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini -Simnica, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarit B. S., për shkak të veprës penale lëndimi i rëndë trupor nga neni 186 par. 3 lidhur me par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda PKR. nr.252/2022 të datës 19.07.2023 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.34/2024 të datës 21.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 29 prill 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit B. S. e paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda PKR. nr.252/2022 të datës 19.07.2023 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.34/2024 të datës 21.02.2024.

A r s y e t i m

Vendimi i Gjykatës Themelore

Gjykata Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR. nr.252/2022 të datës 19.07.2023, të dënuarin B. S. e ka shpallur fajtor për veprën penale lëndimi i rëndë trupor nga neni 186 par. 3 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe i ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) muaj në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në arrest shtëpiak prej datës 09.12.2022 deri me datë 10.03.2023. I dënuari është obliguar në pagesën e shumës prej 50 €, në emër të paushallit gjyqësor dhe shumën prej 50 €, në fondin për kompensimin e viktimave të krimit, kurse i dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.34/2024 të datës 21.02.2024, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit, avokati Begzat Hajrullahu, pa përcaktuar bazën ligjore, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe aktgjykimet e kundërshtuara t'i anulon dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.136/2024 e datës 22.04.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

Pretendimet e paraqitura në kërkesë

Në kërkesën e mbrojtësit të të dënuarit pretendohet se aktgjykimet e kundërshtuara nuk kanë mbështetje ligjore dhe rrjedhimisht duhet të anulohen për arsye se gjykata e shkallës së parë

nuk ka dhënë arsyetim të fakteve vendimtare, përkundër faktit se ka qenë i qartë fakti se i njëjti ka qenë i rrezikuar nga sulmi i tani të dëmtuarit H. H., ashtu që arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i mjaftueshëm. Në mënyrë të ngjashme pretendohet se ka vepruar edhe gjykata e shkallës së dytë me rastin e vërtetimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë duke dështuar të eliminoj shkeljet e gjykatës së shkallës së parë dhe në vend se të anuloj këtë aktgjykim të njëjtin është munduar që të e arsyetoj.

Pretendohet se me këtë rast dy gjykata kanë bërë shkelje të ligjit penal në dëm të të dënuarit, meqë nuk janë dhënë arsye se i dënuari veprën penale e ka kryer me dashje.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

- kërkesa e të dënuarit është e pabazuar.

Pretendimet e paraqitura në kërkesën e të dënuarit se gjykatat e dy instancave më të ulëta gjyqësore nuk kanë bërë arsyetim të mjaftueshëm të aktgjykimeve të tyre lidhur me faktet vendimtare, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës janë pretendime të pabazuara, meqë në rastin konkret bazuar në aktgjykimin e gjykatës së parë del se është paraqitur arsyetim i plotë dhe i qartë për të gjitha faktet vendimtare përkitazi me këtë çështje penale e veçanërisht përkitazi me veprimet konkrete të të dënuarit. Për më tepër, duke u bazuar në shkresat e kësaj çështje penale vërehet se gjykata e shkallës së parë me vëmendje ka shqyrtuar të gjitha provat e administruara dhe kjo ka rezultuar me ndryshimin e kualifikimit ligjor të veprës penale nga vrasja të tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPPK-së në veprën penale lëndimi i rëndë trupor e për të cilin ndryshim është paraqitur arsyetim gjithëpërfshirës.

Gjithashtu edhe gjykata e shkallës së dytë në arsyetimin e aktgjykimit të saj konkretisht në faqet gjashtë dhe shtatë ka trajtuar në mënyrë të plotë të gjitha pretendimet ankimore e posaçërisht përkitazi me faktin se i dënuari veprën penale e ka kryer në mbrojtje të nevojshme e që lidhur me këtë pretendim është potencuar fakti se edhe vet i dënuari nuk e konteston se vet e ka goditur të dëmtuarin tri herë me thikë e si rezultat i kësaj i njëjti kishte pësuar lëndime të

rënda trupore në shpinë në pjesën mbrapa krahut të djathtë, në këmbë dhe në pjesën e mesit pranë brezit e të cilat janë kualifikuar si lëndime të rënda trupore.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se gjykatat e dy instancave më të ulëta gjyqësore në aktgjykimet e tyre me të drejtë kanë konstatuar se në veprimet të dënuarit janë realizuar të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale lëndimi i rëndë trupor nga neni 186 par. 3 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe po ashtu edhe ana subjektive e veprës penale, meqë duke pasur parasysh mënyrën e kryerjes së veprës penale (tri goditje në pjesë vitale të trupit), mjetin e përdorur (thikë) e posaçërisht natyrën dhe llojin e lëndimeve trupore të shkaktuara, atëherë nuk vihet në asnjë rrethanë në pikëpyetje edhe aspekti i dashjes së të dënuarit që të dëmtuarit të i shkaktoj lëndime trupore, ashtu që me këtë rast del se nuk është shkalur ligji penal në dëm të të dënuarit, siç pa bazë theksohet në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 437 par.1 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr. 245/2024, më 29 prill 2024

B.profesionale,
Mirlinda Mejzini -Simnica

Kryetarja e kolegjit,
Mejreme Memaj